

UDHËZIM
Nr. 602, datë 5.8.2026

**"PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 20, DATË 17.2025 "PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE PËR VLERËSIMIN BIO-PSIKO-SOCIAL TË AFTËSISË
SË KUFIZUAR TEK TË RRRITURIT DHE FËMIJËT DHE METODOLOGJINË E
RISHIKIMIT TË TYRE"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të pikës 2 të kreut III, të vendimit nr. 722, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 20, datë 17.1.2025, "Për miratimin e kriterëve për vlerësimin bio-psiko- social të aftësisë së kufizuar tek të rriturit dhe fëmijët dhe metodologjinë e rishikimit të tyre", bëhen këto ndryshime:

1. Në Kriteret e Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar tek të Rriturit, në kapitullin "Dëmtimet Psikiatrike", në frekuencat e kërkuara të vlerësimit, bëhen këto ndryshime:

a) Prapambetja mendore e moderuar ICD 10-15: F71.9, togfjalëshi "Vlerësimi bëhet çdo dy vjet. Nëse vuan nga sëmundje të tjera bashkëshoqëruese psikiatrike ose sëmundje mjekësore të përgjithshme, çdo 5 vjet" zëvendësohet me "Vlerësimi bëhet 1 herë në 5 vjet".

b) Prapambetja mendore e rëndë ICD 10-15: F72.9, togfjalëshi "Nëse vuan nga sëmundje të tjera bashkëshoqëruese psikiatrike ose sëmundje mjekësore të përgjithshme, rivlerësimi bëhet çdo 10 vjet" zëvendësohet me "Vlerësimi bëhet 1 herë në 10 vjet".

c) Prapambetja mendore e thellë ICD 10-15: F73.9, togfjalëshi "Frekuenca e kërkuar e vlerësimit është çdo 10 vjet, prapambetja e rëndë dhe e thellë mund të jetë ose pa afat" zëvendësohet me "Vlerësimi bëhet 1 herë në 10 vjet ose pa afat".

ç) Çrregullim i spektrit të autizmit ICD 10-15: F84.0, pas togfjalëshit "...edhe mbi 10 vjet" shtohet togfjalëshi "ose pa afat".

2. Në Kriteret e Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar tek fëmijët, në kapitullin "Dëmtimet Psikiatrike", në frekuencat e kërkuara të vlerësimit, bëhen këto ndryshime:

a) Prapambetja mendore e moderuar ICD 10-15: F71, togfjalëshi "1 herë në 3 vjet" zëvendësohet me "1 herë në 5 vjet".

b) Prapambetja mendore e rëndë ICD 10-15: F72, togfjalëshi "Çdo 5 vjet" zëvendësohet me "1 herë në 10 vjet".

c) Prapambetja mendore e thellë ICD 10-15: F73, togfjalëshi "1 herë në 5 vjet" zëvendësohet me "1 herë në 10 vjet".

d) Çrregullim i spektrit të autizmit ICD 10-15: F84.0, në frekuencën e kërkuar të vlerësimit, togfjalëshi "1 herë në 3 vjet" zëvendësohet me "1 herë në 5 vjet".

3. Ngarkohet Shërbimi Social Shtetëror, Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, strukturat e shërbimit shëndetësor parësor dhe dytësor, Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor dhe Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për fëmijët, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala